

31987L0054

Direktivë e Këshillit datë 16 dhjetor 1986, për mbrojtjen ligjore të topografive të produkteve gjysmëpërçuese

Gazeta Zyrtare L 024, 27.01.1987 fq. 0036-0040

Direktivë e Këshillit datë 16 dhjetor 1986, për mbrojtjen ligjore të topografive të produkteve gjysmëpërçuese

KËSHILLI I KOMUNITETEVE EUROPIANE,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Ekonomik European dhe në veçanti nenin 100 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit [1],

Duke pasur parasysh opinionin e Parlamentit European [2],

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social [3],

Meqenëse produktet gjysmëpërçuese po luajnë një rol të rëndësishëm në një gamë të gjerë të industrive dhe teknologjisë së gjysmëpërçuesve, në përputhje me rrethanat mund të konsiderohen të një rëndësie themelore për zhvillimin industrial të Komunitetit;

Meqenëse funksionet e produkteve gjysmëpërçuese varen në pjesën më të madhe nga topografitë e produkteve, dhe përderisa zhvillimi i këtyre topografive kërkon investimin e burimeve të konsiderueshme, njerëzore, teknike dhe financiare, ndonëse topografitë e produkteve të tilla mund të kopjohen nga një pjesë e kostos së nevojshme për zhvillimin e tyre të pavarur;

Meqenëse topografitë e produkteve gjysmëpërçuese nuk janë aktualisht të mbrojtura në mënyrë të qartë në të gjitha Shtetet Anëtare nga legjislacioni ekzistues, dhe një mbrojtje e tillë kur ajo ekziston ka attribute të ndryshme;

Meqenëse disa dallime ekzistuese në mbrojtjen ligjore të produkteve gjysmëpërçuese, të ofruara nga ligjet e Shteteve Anëtare, kanë efekte të drejtpërdrejta negative në funksionimin e tregut të përbashkët si produkte gjysmëpërçuese, për sa i përket gjysmëpërçuesve, këto dallime mund të bëhen më të mëdha kur Shtetet Anëtare të përdorin legjislacionin e ri për këtë çështje;

Meqenëse dallimet ekzistuese që kanë efekte të tilla duhet të mënjahohen dhe të rehat që kanë efekt negativ në tregun e përbashkët duhet të parandalohen;

Meqenëse në lidhje me vazhdimin e mbrojtjes së personave jashtë Komunitetit, Shtetet Anëtare duhet të jenë të lira të veprojnë në emër të tyre për aq sa vendimet e Komunitetit nuk janë marrë brenda një periudhe të kufizuar kohore;

Meqenëse kuadri ligjor i Komunitetit për mbrojtjen e topografive të produkteve gjysmëpërçuese mund, në radhë të parë, të kufizohet në disa parime themelore nga dispozita që saktësojnë kë dhe çfarë duhet të mbrohet, të drejtat ekskluzive mbi të cilat personat e mbrojtur duhet të jenë në gjendje të mbështeten për të autorizuar ose ndaluar akte të caktuara, me përjashtim të këtyre të drejtave, dhe për sa kohë mbrojtja duhet të zgjasë;

Meqenëse çështjet e tjera, për momentin, mund të përcaktohen në përputhje me ligjin kombëtar, në veçanti, nëse regjistrimi apo depozitimi kërkohet si kusht për mbrojtjen dhe, në varësi të një përjashtimi të licencave të dhëna për të vetmen arsye që një periudhë e caktuar kohore ka kaluar, nëse dhe në çfarë kushtesh licencat jo të vullnetshme mund të jepen në lidhje me topografitë e mbrojtura;

Meqenëse mbrojtja e topografive të produkteve gjysmëpërçuese në përputhje me këtë direktivë duhet të jetë pa cenuar zbatimin e disa formave të tjera të mbrojtjes;

Meqenëse masat e mëtejshme lidhur me mbrojtjen ligjore të topografive të produkteve gjysmëpërçuese në Komunitet mund të merren parasysh në një fazë të mëvonshme, nëse është e nevojshme, ndonëse aplikimi i parimeve themelore të përbashkëta nga të gjitha Shtetet Anëtare në përputhje me dispozitat e kësaj direktive është një domosdoshmëri urgjente,

KA MIRATUAR KËTË DIREKTIVË

KAPITULLI I

PËRKUFIZIME

Neni 1

1. Për qëllimet e kësaj direktive:

(a) një “produkt gjysmëpërçues” do të thotë përfundimtar ose një formë e ndërmjetme e ndonjë produkti:

(i) që përbëhet nga një masë materiali e cila përfshin një shtresë materiali gjysmëpërçues; dhe

(ii) që ka një ose më shumë shtresa të tjera që përbëhen nga material përcjellës, izolues apo gjysmëpërçues, shtresa të vendosura sipas një modeli të paracaktuar tredimensional; dhe

(iii) që kanë për qëllim të kryejnë, vetëm ose së bashku me funksionet e tjera, një funksion elektronik;

(b) “topografia e një produkti gjysmëpërçues” do të thotë një seri imazhesh të lidhura, megjithatë të fiksuara ose të koduara;

(i) që përfaqësojnë modelin tredimensional të shtresave nga të cilat përbëhet një produkt

gjysmëpërçues; dhe

(ii) në secilën seri, çdo imazh ka modelin ose një pjesë të modelit të sipërfaqes së produktit gjysmëpërçues në çdo fazë të prodhimit të tij;

(c) “shfrytëzimi në treg” do të thotë shitje, qiradhënie ose ndonjë metodë tjetër e shpërndarjes tregtare, ose një ofertë për këto qëllime. Megjithatë, për qëllimet e nenit 3, pika (4), nenit 4, pika (1), nenit 7, pika (1), (3) dhe (4), “shfrytëzimi në treg” nuk përfshin shfrytëzimin në kushtet e konfidencialitetit ose besimit në masën që nuk ka shpërndarje të mëtejshme tek palët e treta, përveç rastit kur shfrytëzimi i një topografie ndodh në kushtet e konfidencialitetit kërkuar nga një masë e marrë në pajtim me nenin 223, pika (1), shkronja (b) e Traktatit.

2. Këshilli duke vepruar me shumicë të cilësuar, me propozim të Komisionit, mund të ndryshojë paragrafin 1 shkronjat (a) (i) dhe (ii) në mënyrë që të përshtaten këto dispozita në përputhje me progresin teknik.

KAPITULLI II

MBROJTJA E TOPOGRAFIVE TË PRODUKTEVE GJYSMËPËRÇUESE

Neni 2

1. Shtetet Anëtare mbrojnë topografinë e produkteve gjysmëpërçuese duke zbatuar dispozitat ligjore në dhënien e të drejtave ekskluzive në përputhje me dispozitat e direktivës.

2. Topografia e një produkti gjysmëpërçuese mbrohet për aq sa ajo plotëson kushtet për të qenë rezultat i përpjekjeve intelektuale të vetë krijuesit të saj, dhe nuk është e zakonshme në industrinë e gjysmëpërçuesve. Kur topografia e një produkti gjysmëpërçues përbëhet nga elemente që janë të zakonshëm në industrinë e gjysmëpërçuesve, ajo duhet të mbrohet vetëm në masën kur kombinimi i elementeve të tilla, marrë si një e tërë, plotëson kushtet e mësipërme.

Neni 3

1. Varësisht nga paragrafët 2 deri 5, e drejta për mbrojtje zbatohet në favor të personave të cilët janë krijuesit e topografive të produkteve gjysmëpërçuese

2. Shtetet Anëtare mund të sigurojnë që:

(a) kur një topografi krijohet gjatë punësimit të krijuesit, e drejta për mbrojtje zbatohet në favor të punëdhënësit të krijuesit, përveç rasteve kur kushtet e punësimit parashikojnë të kundërtën;

(b) kur një topografi krijohet në bazë të një kontrate, me përjashtim të një kontrate pune, e drejta për mbrojtje zbatohet në favor të asaj pale të kontratës nga e cila topografia është porositur, përveç rasteve kur në kontratë parashikohet për të kundërtën.

3. (a) në lidhje me personat e përmendur në paragrafin 1, e drejta për mbrojtje zbatohet në favor të personave fizikë që janë shtetas të një Shteti Anëtar ose që kanë vendbanimin e tyre në territorin e një Shteti Anëtar.

(b) kur Shtetet Anëtare marrin masa në përputhje me paragrafin 2, e drejta për mbrojtje zbatohet në favor të:

(i) personave fizikë, të cilët janë shtetas të një Shteti Anëtar ose të cilët kanë vendbanimin e tyre të përhershëm në territorin e një Shteti Anëtar;

(ii) kompanive apo personave të tjerë juridikë që kanë një ndërmarrje ose institucion real dhe efektiv industrial ose tregtar në territorin e një Shteti Anëtar.

4. Kur nuk ekziston e drejta për mbrojtje në përputhje me dispozitat e tjera të këtij neni, e drejta për mbrojtje zbatohet edhe në favor të personave të përmendur në paragrafin 3, shkronjat (b), (i) dhe (ii), të cilët:

(a) shfrytëzojnë të parët nga ana komerciale në një Shtet Anëtar një topografi e cila ende nuk shfrytëzohet në treg kudo në botë; dhe

(b) janë të autorizuar të shfrytëzojnë në treg topografinë në të gjithë Komunitetin nga ana e personit që ka të drejtën e rregullimit të saj.

5. E drejta për mbrojtjen zbatohet gjithashtu në favor të trashëgimtarëve në emër të personave të përmendur në paragrafët 1 deri 4.

6. Në bazë të paragrafit 7, Shtetet Anëtare mund të negociojnë dhe të lidhin marrëveshje ose memorandume mirëkuptimi me shtetet e treta dhe Konventën shumëpalëshe, në lidhje me mbrojtjen ligjore të topografive të produkteve gjysmëpërçuese, duke respektuar ligjin e Komunitetit dhe në veçanti rregullat e përcaktuara në këtë direktivë.

7. Shtetet Anëtare mund të hyjnë në negociata me shtetet e treta me qëllim që të zgjerojnë të drejtën për mbrojtje për personat që nuk përfitojnë nga e drejta për mbrojtje, sipas dispozitave të kësaj direktive. Shtetet Anëtare që hyjnë në bisedime të tilla informojnë Komisionin.

Kur një Shtet Anëtar dëshiron të zgjerojë mbrojtjen për persona që në rast të kundërt nuk përfitojnë nga e drejta për mbrojtje, sipas dispozitave të kësaj direktive, ose të përfundojë një marrëveshje ose mirëkuptim me një shtet joanëtar për vazhdimin e mbrojtjes, ai njofton Komisionin. Komisioni informon Shtetet e tjera Anëtare të tij. Shteti Anëtar e ruan vazhdimin e mbrojtjes, marrëveshjen apo mirëkuptimin në gjendje pezull për një muaj nga data në të cilën ai njofton Komisionin. Megjithatë, në qoftë se brenda kësaj periudhe Komisioni njofton Shtetin Anëtar në fjalë për qëllimin e tij për t'i paraqitur Këshillit një propozim për të gjitha Shtetet Anëtare për të zgjeruar mbrojtjen në lidhje me personat apo shtetin joanëtar në fjalë, Shteti Anëtar e ruan vazhdimin e mbrojtjes, marrëveshjen apo mirëkuptimin në gjendje pezull për dy muaj nga data në të cilën ai njofton Komisionin.

Kur përpara përfundimit të kësaj periudhe dymujore Komisioni i paraqet Këshillit një propozim të tillë, Shteti Anëtar e ruan vazhdimin e mbrojtjes, marrëveshjen apo mirëkuptimin në gjendje

pezull për një periudhë të mëtejshme prej katër muajsh nga data në të cilën është paraqitur propozimi.

Në mungesë të një njoftimi apo propozimi të Komisionit, apo të një vendimi të Këshillit brenda afateve të përcaktuara më lart, Shteti Anëtar mund ta zgjasë mbrojtjen, përfundimin e marrëveshjes ose memorandumin e mirëkuptimit.

Një propozim nga Komisioni për të zgjeruar mbrojtjen, nëse është bërë apo jo pas një njoftimi nga një Shtet Anëtar, në përputhje me paragrafët e mësipërm, miratohet nga Këshilli duke vepruar me shumicë të cilësuar.

Një vendim i Këshillit, në bazë të një propozimi të Komisionit, nuk e ndalon një Shtet Anëtar të zgjerojë mbrojtjen ndaj personave, përveç atyre që përfitojnë nga mbrojtja në të gjitha Shtetet Anëtare, që përfshiheshin në zgjerimin, marrëveshjen ose mirëkuptimin e parashikuar siç njoftohej, veç nëse Këshilli duke vepruar me shumicë të cilësuar ka vendosur ndryshe.

8. Propozimet e Komisionit dhe vendimet e Këshillit në përputhje me paragrafin 7 publikohen për informacion në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Neni 4

1. Shtetet Anëtare mund të garantojnë që të drejtat ekskluzive të fituara, në përputhje me nenin 2, nuk bëhen të disponueshme ose nuk zbatohen për topografinë e një produkti gjysmëpërçues, nëse nuk paraqitet një kërkesë për regjistrim në formën e duhur nga një autoritet publik brenda dy viteve të shfrytëzimit të saj të parë në treg. Shtetet Anëtare mund të kërkojnë, përveç këtij regjistrimi, që materiali identifikues ose kopja e vërtetuar e topografisë ose ndonjë kombinim i saj të depozitohet nga një autoritet publik, si dhe deklaratën për datën e shfrytëzimit të parë komercial të topografisë, kur ajo i paraprin datës së aplikimit për regjistrim.

2. Shtetet Anëtare sigurojnë që materiali i depozituar në përputhje me paragrafin 1 nuk vihet në dispozicion për publikun, kur ai është sekret tregtar. Kjo dispozitë nuk cenon zbulimin e këtij materiali në vijim të një urdhri nga një gjykatë ose autoritet tjetër kompetent ndaj personave të përfshirë në çështje gjyqësore lidhur me vlefshmërinë ose shkeljen e të drejtave ekskluzive të përmendura në nenin 2.

3. Shtetet Anëtare mund të kërkojnë që transferimet e të drejtave për topografite e mbrojtura të regjistrohen.

4. Shtetet Anëtare mund të kushtëzojnë regjistrimin dhe depozitimin në përputhje me paragrafët 1 dhe 3 për pagesën e taksave që nuk i kalojnë shpenzimet e tyre administrative.

5. Kushtet që përcaktojnë përmbushjen e formaliteteve të tjera për marrjen ose mbajtjen e mbrojtjes nuk do të pranohen.

6. Shtetet Anëtare, të cilat kërkojnë regjistrimin, sigurojnë mjetet juridike në favor të personit që ka të drejtën e mbrojtjes në përputhje me dispozitat e kësaj direktive që mund të provojë se personi tjetër ka aplikuar për, ose ka bërë regjistrimin e një topografie pa autorizimin e tij.

Neni 5

1. Të drejtat ekskluzive të referuara në nenin 2 duhet të përfshijnë të drejtat për të autorizuar ose ndaluar ndonjë prej akteve të mëposhtme:

(a) riprodhimin e një topografie deri në atë shkallë sa të jetë e mbrojtur sipas nenit 2, pika (2);

(b) shfrytëzimin tregtar ose importimin për këtë qëllim të një topografie apo të një produkti gjysmëpërçues të prodhuar duke përdorur topografinë.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, një Shtet Anëtar mund të lejojë riprodhimin e një topografie në veçanti për qëllime jotregtare.

3. Të drejtat ekskluzive të referuara në paragrafin 1, shkronja (a) nuk zbatohen për riprodhimin me qëllim analizimin, vlerësimin ose për të mësuar konceptet, proceset, sistemet apo teknikat e mishëruara në topografi ose topografinë vetë.

4. Të drejtat ekskluzive të referuara në paragrafin 1 nuk shtrihen në çdo akt të tillë në lidhje me një topografi që përmbush kërkesat e nenit 2, pika (2), dhe e krijuar mbi bazën e një analize dhe vlerësimi të një topografie tjetër, kryer në përputhje me paragrafin 3 .

5. Të drejtat ekskluzive për të autorizuar ose ndaluar aktet e specifikuar në paragrafin 1, shkronja (b) nuk zbatohen për çdo akt që kryhet, pasi topografia ose produkti gjysmëpërçues hidhet në treg në një Shtet Anëtar nga personi që ka të drejtën të autorizojë marketingun e saj, ose me pëlqimin e tij.

6. Një person, i cili kur siguron një produkt gjysmëpërçues nuk e di ose nuk ka baza të arsyeshme për të besuar se produkti mbrohet nga një e drejtë ekskluzive e dhënë nga një Shtet Anëtar në përputhje me këtë direktivë, nuk pengohet që ta hedhë në treg atë produkt.

Megjithatë, për aktet e kryera, pasi personi mëson ose ka arsye për të besuar se produkti gjysmëpërçues është i mbrojtur, Shtetet Anëtare sigurojnë me kërkesën e autorit që një gjykatë të kërkojë pagesën adekuate në përputhje me dispozitat e ligjit kombëtar të zbatueshëm.

7. Dispozitat e paragrafit 6 zbatohen për trashëgimtarët në emër të personit që përmendet në fjalinë e parë të atij paragrafi.

Neni 6

Shtetet Anëtare nuk i kushtëzojnë të drejtat ekskluzive të përmendura në nenin 2 për licencat e dhëna, për arsyen e vetme që një periudhë e caktuar kohe ka kaluar, automatikisht, nëpërmjet veprimit të ligjit.

Neni 7

1. Shtetet Anëtare sigurojnë që të drejtat ekskluzive të referuara në nenin 2 të bëhen të disponueshme:

(a) kur regjistrimi është kusht që të drejtat ekskluzive të bëhen të disponueshme në përputhje me nenin 4 në datat e mëposhtme:

(i) data kur topografia shfrytëzohet për herë të parë në treg diku në botë;

(ii) data kur një kërkesë ose regjistrim paraqitet në formën e duhur, ose

(b) kur topografia hidhet në treg për herë të parë diku në botë; ose

(c) kur topografia caktohet ose kodohet për herë të parë.

2. Kur të drejtat ekskluzive ekzistojnë në përputhje me paragrafin 1, shkronja (a) ose shkronja (b), Shtetet Anëtare sigurojnë për periudhën para se ato të drejta të lindin mjetet juridike në favor të një personi që ka të drejtën e mbrojtjes në përputhje me dispozitat e kësaj direktive, që mund të provojnë se një person tjetër ka riprodhuar me mashtrim apo ka shfrytëzuar në treg, ose ka importuar për këtë qëllim një topografi. Ky paragraf nuk cenon mjetet juridike në dispozicion për të zbatuar të drejtat ekskluzive të fituara në përputhje me nenin 2.

3. Të drejtat ekskluzive përfundojnë 10 vjet nga fundi i vitit kalendarik në të cilin topografia është shfrytëzuar për herë të parë në treg diku në botë, ose kur regjistrimi është kusht për të ekzistuar ose vazhduar zbatimin e të drejtave ekskluzive, 10 vjet nga datat e mëposhtme:

(a) fundi i vitit kalendarik në të cilin topografia është shfrytëzuar për herë të parë në treg diku në botë;

(b) fundi i vitit kalendarik në të cilin kërkesa për regjistrim është paraqitur në formën e duhur.

4. Kur një topografi nuk shfrytëzohet në treg diku në botë brenda një periudhe prej 15 vjetësh nga caktimi apo kodimi i saj i parë, çdo e drejtë ekskluzive ekzistuese në bazë të paragrafit 1 përfundon dhe asnjë e drejtë e re ekskluzive nuk lind, përveçse një aplikimi për regjistrim në formën e duhur që dorëzohet brenda kësaj periudhe në ato Shtete Anëtare ku regjistrimi është kusht për vazhdimin e zbatimit të të drejtave ekskluzive.

Neni 8

Mbrojtja që jepet për topografitë e produkteve gjysmëpërçuese në përputhje me nenin 2 nuk shtrihet në ndonjë koncept, proces, sistem, teknikë ose informacion i koduar që mishërohet në topografi përveçse në vetë topografinë.

Neni 9

Kur legjislacioni i Shteteve Anëtare siguron se produktet gjysmëpërçuese prodhohen duke përdorur topografi të mbrojtura, mund të mbartin një tregues; treguesi që përdoret është një shkronjë e madhe T si vijon: T, "T", [T], T, T * apo T.

KAPITULLI III

KËRKESA E VAZHDUESHME E DISPOZITAVE TË TJERA LIGJORE

Neni 10

1. Dispozitat e kësaj direktive nuk cenojnë dispozitat ligjore në lidhje me të drejtat për patentat dhe modelet e përdorimit.
2. Dispozitat e kësaj direktive nuk cenojnë:
 - (a) të drejtat e akorduara nga Shtetet Anëtare në përmbushjen e detyrimeve të tyre, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, përfshi këtu dispozitat që i shtrijnë këto të drejta tek shtetasit apo banorët në territorin e Shtetit Anëtar në fjalë;
 - (b) ligjin e të drejtës së autorit në Shtetet Anëtare, që kufizon riprodhimin e modeleve industriale ose paraqitjen e topografive të tjera artistike të kopjuar në dy dimensione.
3. Mbrojtja e parashikuar nga ligji kombëtar për topografitë e produkteve gjysmëpërçuese të caktuara ose koduara para hyrjes në fuqi të dispozitave kombëtare që miratojnë direktivën nuk ndikohet nga dispozitat e kësaj direktive, por jo më vonë se data e përcaktuar në nenin 11 pika 1.

KAPITULLI IV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 11

1. Shtetet Anëtare sjellin në fuqi ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative të nevojshme në përputhje me këtë direktivë deri më 7 nëntor 1987.
2. Shtetet Anëtare sigurojnë që ata t'i komunikojnë Komisionit tekstet e dispozitave kryesore të ligjit kombëtar që ata miratojnë në fushën e mbuluar nga kjo direktivë.

Neni 12

Kjo direktivë i drejtohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 16 dhjetor 1986.

Për Këshillin

Presidenti

G. HOWE

[1] GZ C 360, 31. 12. 1985, fq. 14.

[2] GZ C 255, 13. 10. 1986, fq. 249.

[3] GZ C 189, 28. 7. 1986, fq. 5.